



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 82 datë 25.08 2026

“PËR PRANIM NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE GJIROKASTËR”

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore “, pikës 6 të nenit nr 28 të Ligjit nr 9355, date 10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”i ndryshuar, VKM-së nr 209,date 12.04.2006 dhe Udhëzimit nr 2470,date 06.12.2006, VKM-së nr 425,date 27.06.2012 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave ne institucionet rezidenciale, VKM Nr 839 datë 03.12.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr 425 datë 27.06.2012 “Për kriteret e vendosjes në institucione rezidenciale të përkujdesit shoqëror dhe dokumentacionin e nevojshëm për pranim”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak.

VENDOSI:

1. Të miratojë strehimin e qytetarit:

Irakli Proko me vendbanim në Zhepë - Përmet, i moshuar, i vetmuar, për t’iu dhënë e drejta e kalimit në Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastër për strehim, si banor i Qarkut Gjirokastër.

2. Kërkohet për Z. Irakli Proko përkujdesje nga ky institucion për shkak të moshës së tij.

3. Dokumentacioni të kalojë në Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastër.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE

KRYETAR
Anila DHIMITRI

